

Me deputetin e Pogradecit Fatbardh Kadilli: Njerëzit preferojnë Pogradecin, si vendin ku ndërtojnë jetën e tyre

“Votuesi është i mënçur, edhe kur të ndëshkon me votën e tij!”

Pogradeci dhe Mokra kanë një perspektivë shumë optimiste dhe baza e saj janë njerëzit e mrekullshëm, punëtorë dhe të ndershëm, janë traditat e mira, si dhe burimet natyrore që në këtë rreth i kemi me shumicë.

Nga Flori SLATINA

Për herë të dytë në faqet e gazetës “Mokra” deputeti i nderuar i Pogradecit, Fatbardh Kadilli, i bën një analizë të saktë zgjedhjeve lokale të 8 majit si dhe gjendjes dhe perspektivës së Mokrës e Pogradecit. Nuk ka humbës, ka të fituar, ka 60 mijë vota më tepër për koalicionin e djathtë, sikurse ka një analizë e refleksion të qartë mbi humbjen e disa kandidatëve për kryetarë në disa komuna. Për Kadillin “Votuesi është i mënçur edhe kur të ndëshkon!”

duke pasur parasysh se shkaqet e një rezultati të dobët nuk duhen kërkuar tek votuesi por tek i votuari. Hapja e tunelit të Krrabës është një perspektivë e mirë për Mokrën dhe rrethin, pasi shkurton distancën dhe rrit cilësinë e jetës. “Qeveria ka ndjekur një politikë të kujdes-shme financiare, ka shtyrë edhe ndonjë projekt investimi, por ka evituar krizën ekono-mike”, gjë që flet për një garanci të një e ardhme më e mirë për vendin, sepse fakti që nuk po braktiset Pogradeci do të thotë se njerëzit e duan vendin dhe dëshirojnë të jedtojnë e të vdesin aty. (vijon në faqen 2)



Në 68-vjetorin e saj

Beteja e Pojskës

Nga Llazi TONA



Koleksioni fotografik i Gushiqit për Pogradecin

RAJCA E JONË SHUMË E LASHTË

Poezi nga Bashkim ÇUKU

KROI ÇETËRË PRET MYSAFIRË NË ÇDO KOHË

Nga Zenun FERRO

Kroi Çetërë, është rregulluar nga bullgarët në vitin 1916, me katër puse, mbi dy metra të thellë, në vazhdim të njëri pas tjetrit. Duke pasur katër puse u quajt nga bullgarët “Çetirje”, kështu i thonë katrës në gjuhën bullgare dhe më vonë nga banorët e fshatit Slabinjë është shqiptuar “Çetëra”, (Zenun Fero, “Slabinja jonë Monografi Tiranë 2005 faqe 170). Çezma e Çetërës plotësonte kërkesat me ujë të pijshëm fisin Fero, Balliu, Bego, Sinani e tjerë, gjithë fshatin Slabinjë në raste në thatësira të zgjatura. Rrugët që të çojnë te kroi janë tre, rruga e Ferove, Ballive, dhe një nga lart fisi Balliu. Këto rrugë ishin shëtitja e banorëve, gjatë ditës, dhe të shumta gjatë mbërmjes, me



Premtim i parealizuar linja me anije Ohër-Pogradec



Sirenat e Liknidës

Nga Kristaq NANUSHI

Ritet zakonore në zonën e Mokrës

Nga Zabit ÇUKU e Bashkim KRASTA

Një fundjavë në bregdetin me pisha të Divjakës

Nga Koço PIHONI

Me deputetin e Pogradecit Fatbardh Kadilli: Njerëzit preferojnë Pogradecin, si vendin ku ndërtojnë jetën e tyre

“Votuesi është i mënçur, edhe kur të ndëshkon me votën e tij!”

Nga Flori SLATINA

Për herë të dytë në faqet e gazetës “Mokra” deputeti i nderuar i Pogradecit, Fatbardh Kadilli, i bën një analizë të saktë zgjedhjeve lokale të 8 majit si dhe gjendjes dhe perspektivës së Mokrës e Pogradecit. Nuk ka humbës, ka të fituar, ka 60 mijë vota më tepër për koalicionin e djathtë, sikurse ka një analizë e refleksion të qartë mbi humbjen e disa kandidatëve për kryetarë në disa komuna. Për Kadillin “Votuesi është i mënçur edhe kur të ndëshkon!”, duke pasur parasysh se shkaqet e një rezultati të dobët nuk duhen kërkuar tek votuesi por tek i votuari. Hapja e tunelit të Krrabës është një perspektivë e mirë për Mokrën dhe rrethin, pasi shkurton distancën dhe rrit cilësinë e jetës. “Qeveria ka ndjekur një politikë të kujdes-shme financiare, ka shtyrë edhe ndonjë projekt investimi, por ka evituar krizën ekono-mike”, gjë që flet për një garanci të një e ardhme më e mirë për vendin, sepse fakti që nuk po braktiset Pogradeci do të thotë se njerëzit e duan vendin dhe dëshirojnë të jetojnë e të vdesin aty.

- Zgjedhjet e fundit lokale në Pogradec pro-dhuan një rezultat negativ për PD-ne, në veçanti, dhe zhgenjyes për Aleancën për Qytetarin, pasi vetëm dy komuna u fituan prej tyre. Si e shikoni dhe si e komentoni Ju këtë rezultat?

Fatbardh Kadilli: - Së pari, më lejoni të them se zgjedhjet e fundit ishin një fitore për shoqërinë shqiptare. Në këto zgjedhje morën pjesë më shumë votues dhe nuk pati asnjë incident, asnjë problem si gjatë ditës së votimit ashtu edhe gjatë administrimit të numërimit dhe shpalljes së rezultateve. Ky pohim nuk është një klishe politike, është një fakt që e përcollën sytë e çdo shqiptari. Edhe në rrethin e Pogradecit nuk pati asnjë ngjarje, sado e izoluar që të përgënjesh-trojë këtë pohim. Prandaj zgjedhjet ishin një fitore për demokratë dhe socialistë, për të djathtë, të qëndrës dhe të majtë.

Sa për rezultatin që zgjedhjet prodhuan duhet t’ju bëj një korigjim. Në këto zgjedhje “Aleanca për Qytetarin” fitoi me një diferencë rreth 3500 vota, përballë koalicionit të majtë. Vërtet kandidatët e AQ humbën në katër Komuna, por zgjedhësit kanë votuar bindshëm për subjektet dhe koalicioni i drejtuar nga PD ka fituar shumicën e vendeve në këshilla në tre nga këto komu-



na. Për këdo që tenton ta injorë, ose të mos e marrë në konsideratë rezultatin e votave për subjektet e koalicioneve dua t’i kujtoj që eksperiencia e zgjedhjeve të mëparshme lokale provon se shpërndarja e votave brenda partive të koalicioneve tenton të rigrupohet tek partitë e mëdha në votimin për parlamentin, nga i cili del edhe qeveria.

Rezultati i zgjedhjeve të fundit rikonfirmojë, në Pogradec si në gjithë Shqipërinë me një përmirësim të vogël në favor të koalicionit të PD-së, rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2009. Koalicioni ynë fitoj më rreth 600 vota në rrethin e Pogradecit në 2009 dhe, duke u bashkuar edhe LSI, kjo diferencë u thellua ndjeshëm. Megjithatë, nuk mund të injorohet nga unë humbja e kandidatëve për kryetar sidomos në komunat Çërave, Dardhas dhe Hudënisht, ku ne kemi fituar thellë si koalicion. Kjo është humbja për të cilën ne po reflektojmë.

- Si u bë përzgjedhja e kandidatëve, kur për një pjesë të tyre pati konstatime. A mendosi se shumica e fajit bie mbi ta, punën e tyre dhe reputacionin e ulët?

Përzgjedhja e kandidatëve u bë në përputhje me statutin e Partisë Demokratike, kur kandidatët ishin të forcës tonë politike dhe në konsultim me aleatët për rastet e kandidatëve të përbashkët që në rastin e Pogradecit vinin nga LSI. Struktuarat janë konsultuar gjerësisht. Në përgjithësi nuk ka pasur kontestime, madje në rastet si Çërrava dhe Dardhasi nuk pati as kandidatura alternative brenda PD-së. Rivaliteti pati më shumë në Hudënisht dhe diçka më pak në komunat

e Mokrës, Proptisht dhe Velçan. Shkaqet e humbjes së kandidatëve tanë në këto komuna mund të jenë të shumtë, por nuk kanë të bëjnë me mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve. Nuk ka forcë politike dhe nuk ka politikan që të mbështes një kandidat që nuk e beson fitues. Ne si forcë politike kemi pasur bindjen që kandidatët tanë janë përzgjedhja jonë më e mirë. Të gjithë kishin të paktën një apo edhe dy mandate si kryetarë të komunave të tyre. Gjatë kësaj periudhe kanë realizuar investime të rëndësishme për komunitet e tyre, kanë drejtuar me ambicje dhe përkushtim. Jam i bindur se e mira e tyre nuk do të harrohet dhe ata meritojnë një falenderim për atë që kanë bërë në vitet që drejtuan komunat. Gjithësesi, fakti që humbën tregon se diçka nuk ka funksionuar në raportet e tyre me mbështetjen elektorale dhe në ndonjë rast edhe me strukturat e partisë. Votuesi është i

mënçur edhe kur të ndëshkon. Unë dëshiroj ta shikoj pozitivisht rezultatin të paktën në një aspekt, në aspektin e sjelljes së mbështetësve tanë. Për mua është vlerë e shtuar për shoqërinë tonë demokratike sjellja e elektoratit të djathtë që ndëshkon kandidatët të cilët i gjykon të papërshtatshëm, madje edhe në ato raste kur ata kanë kryer investime që kanë ndryshuar jetën e banorëve të komunës. Por, e përsëris, është një dukuri që vërehet tek elektorati i djathtë dhe aspak tek ai i majtë. Kjo ndodhi në shumë komuna dhe bashki të vendit. Kujtoj këtu Kavajën, Laçin, Burrelin, Kru-mën, si dhe rastin e komunave të rrethit tonë si Çërava dhe deri diku Hudënisht. Por, kjo dukuri nuk gjendet tek elektorati i majtë. Rasti i Bashkisë Pogradec është më i dukshmi. Qytetarët e pogradecarë e shikojnë përditë abuzimin e kryetarit të bashkisë, i dinë dhe pohojnë përditë bëmat e tij, arbitrarite-

Pogradeci dhe Mokra kanë një perspektivë shumë optimiste dhe baza e saj janë njerëzit e mrekullshëm, punëtorë dhe të ndershëm, janë traditat e mira, si dhe burimet natyrore që në këtë rreth i kemi me shumicë.

tin, përdorimin e postit në konflikt të dukshëm interesi, por, përsëri votojnë në favor të tij, vetëm se në shumicë votojnë majtas. Është shenjë pjekurie politike për shoqërinë kur të arrijmë të votojmë për njerëzit më të mirë, për ata që besojmë se do shërbejnë më mirë, pavarësisht nga ngjyrimi politik. Megjithatë, edhe në Pogradec ka një përmirësim të diferencës së kandidatëve e të koalicioneve respektive krahasuar me rezultatet historike në qytet.

- PD e Pogradecit ka nevojë për një ristrukturim, riorganizim, e shtrire deri në fshatra e komuna. A mundet dhe a do bëhet kjo për të pasur një rezultat shumë më të mirë në zgjedhjet e përgjithshme në 2013?

Nuk besoj se PD ka nevojë për ristrukturim, apo riorganizim. Një forcë politike që qeveris vendin, që drejton një koalicion fitues në katër zgjedhjet e fundit në vend, që fiton për herë të dytë radhasi në rreth është forcë politike që ka sukses dhe struktura dhe organizimi i saj janë të suksesshme. Natyrisht rezultati i



Premtim i parealizuar linja me anije Ohër-Pogradec



Linja me anije Ohër-Pogradec edhe më tej mbetet vetëm një dëshirë e qytetarëve të Ohrit. Pesë vjet nga premtimi i parë i ministrave të atëhershëm të Transportit dhe Lidhjeve të Maqedonisë dhe Shqipërisë, se do të bëjnë çmos që linja të funksionojë, mbetën vetëm

paralajmërime.

"Nëse pala shqiptare është e gatshme që të hapet kjo linjë, nga pala jonë nuk ka pengesa. Bëhet fjalë për transport të lirë të udhëtarëve, nëse ka interes, transporti i rregullt do të hapej me itinerar të rregullt. Dobi nga kjo do të ketë vetëm Shqipëria, sepse atje do të derdhen vetëm

devizat", tha Lupço Nastevs-ki, kapiten në Kapitanerinë e Ohrit. Ndërkaq nga komuna e Pogradecit thonë se qysh disa vjet më parë janë ndër-marrë të gjitha masat e nevojshme për linjën. Saktësisht dihet se do të bëhet kontrolli i pasaportave dhe si do të pranohen udhëtarët pas mbërritjes në portin e Pogradecit, thonë prej atje. Kryetari i komunës së Ohrit, Aleksandër Petreski citohet të ketë thënë se shteti nuk është i interesuar këtë linjë dhe se me Kapitanerinë duhet të menaxhojë komuna.

"Nuk janë shumë të interesuar për këtë punë. Sa po punojnë edhe ju po e shikoni. Konsiderojë se Kapitaneria e Ohrit duhet të kalojë nën pushtetin vendor. Atëherë me siguri do të biem dakord për linjën me anije", ka thënë Petreski.

"Nuk ka interesim. Njerëzit pyesin, mirëpo ne nuk jemi kompetent. Kur do të thonë se çdo gjë është gati, ne jemi të gatshëm të shkojmë. Megjithatë bëhet fjalë për një

çështje ndërkombëtare", tha Goran Cvetković, anija "Galeb".

Linja me Pogradecin do të jetë e mirë edhe për turizmin. "Oferta do të rritet për turistët që vijnë këtu. Nuk do t'i vozisim me autobus një orë e gjysmë, por me anije ku do të mund t'i shohin të gjitha bukuritë, kurse oferta do të shtohet edhe me shëtitje deri në Pogradec. Prandaj ne kërkojmë që linja të funksionojë" tha Oleg Malenko, punonjës turistik.

Për herë të parë në vitin 1993, kompania "Ribo komerc" bëri një kërkesë në Ministrinë atëhershme të Transportit dhe Lidhjeve për transportin e udhëtarëve me anije deri në Pogradec. Ideja ishte që anija të qarkullojë dy herë në javë, kurse 20 për qind e të ardhurave të shkojnë në buxhetin e shtetit. Mirëpo edhe pas 15 vjetësh anija kursesi të niset. Edhe këtë sezon turistik zgjidhja e vetme për shëtitje deri në anën tjetër të kufirit është vetëm me makinë ose autobus.

papëlqyshëm i kandidatëve për kryetar, në të paktën tre nga komunat ku koalicioni ka dalë fitues, kërkon reflektim dhe ndryshimet e nevojshme nga partia. PD do të bëjë analizë e saj dhe po e bën. Një gjë duhet të jetë e qartë, analizat në PD nuk do të jenë mundësi spekulli-mesh. E ritheksoj se jemi forcë politike serioze që udhëhiqemi nga vullneti për t'i shërbyer më mirë qytetarëve, votuesve dhe për të bërë këtë duhet që të gjithë anëtarët dhe simpatizantët të japin ndihmesë. Analiza jonë e deritashme na ka dhënë indici për shkaqet dhe fenomenet që na dëmtojnë në rastet e humbjeve dhe do të ndahen përgjegjësitë. Por, analizat shërbejnë për të identifikuar rrugët dhe burimet që zgjerojnë mbështetjen politike.

- **Si e shikoni persektiven, zhvillimet e vendit dhe te Mokres e Pogradecit ne vijimesi.**

- Vendi po kalon një periudhë të rëndësishme transformimesh. Investimet e mëdha në infrastrukturë po fillojnë të japi efektet e veta pozitive. Ndoshta edhe për 4-5 vjetë orientimi politik do të jetë drejt ndërtimit të rru-gëve kryesore të vendit. Shqipëria është vend me terren të thyer dhe kjo ka bërë që fshatra dhe krahina të tëra të mbeten të izoluara nga zhvillimi. Rrugët janë shpë-timi. Ndërtimi i tunelit të Krrabës, edhe pse larg nga rrethi ynë, është një investim madhor që do shkurtojë kohën dhe do të lehtësojë lëvizjen për në Tiranë. Ndikimi i tij do të jetë i jashtëzakonshëm. Shqipërisë i duhet të krijojë atë që s'e ka pasur stokun e rrugëve nacionale dhe atyre rurale. Paralel me investimet infrastrukturale një vend të rëndësishëm do të ketë investimi në ato sektorë të ekonomisë që janë në traditën tonë më të mirë dhe në mundësitë tona. Agrobiznesi do të ketë më shumë subvencione dhe forma të tjera mbështetje dhe sidomos për rrethin tonë bashkë me industrinë e lehtë dhe turizmin do jenë shtyllat e zhvillimit dhe mirqenjas. Kam bindje se vështirësitë që përjetojmë nga kriza financiare që gjuhëzojnë vende si Greqia e deri diku edhe Spanja do ketë ndikim, por nuk do ndalin rritjen ekono-mike. Qeveria ka ndjekur një politikë të kujdesshme financiare, ka shtyrë edhe ndonjë projekt investimi, por ka evituar krizën ekono-mike nga e cila një vend si ne dëmtohet me më shumë pasojë edhe se Greqia fqinje. Pogradeci dhe Mokra kanë një perspektivë shumë optimiste dhe baza e saj janë njerzit e mrekullushëm, punëtor dhe të ndershëm, janë traditat e mira dhe janë burimet natyrore që në këtë rreth i kemi me shumicë. Mjafton t'ju kujtoj një të dhënë statistikore. Prej vitit 1991, pavarësisht levizjeve demografike dhe emigracionit, Pogradeci rritet në popullsi, ndërkohë që Korça bien në numër. Kjo jep shenjën se njerëzit preferojnë Pogradecin si vendin ku ndërtojnë jetën e tyre.

- **Ju Faleminderit!**

Fuat Fero, zyretarisht kryetar, fillon nga puna

Në ambientet e gimnazit të fshatit Proptisht u bë mbledhja e parë e këshillit të komunës Proptisht. Pjesëmarrës në këtë mbledhje ishin 15 anëtarët e këshillit, kryetari z.Fuat Fero, simpatizantë të të dy krahëve politikë, të ftuar, gjithashtu edhe z.Niko Duda, n/prefekt i Pogradecit.

Pesëmbëdhjetë anëtarët e këshillit, konkretisht 8 anëtarë të koalicionit të majtë dhe 7 të koalicionit të djathtë, që dolën nga zgjedhjet e 8 majit: Neim Pengu (PS), Guri Çela (PS), Xhevit Nofulla (PS), Bexhet Korça (PS), Përparim Hidri (PSD), Shkëlqim Barçi (PDK), Fuat Zykollari (LSI), Eglantina Korça (PDS), të gjithë të koalicionit të majtë dhe grupimi tjetër i të djathtëve: Xhevdet Bego (PD), Përparim Gorrica, Përparim Sula, Xhemal Puro, Esat Kapri, Ramiz Kume, Arjan Pura.

Pas votimit Kryetar këshilli u zgjodh z. Përparim Hidri, i koalicionit tëmajtë, me 10 vota, kundrejt Xhevdet Begos, i koalicionit të djathtë, me 5 vota.



Nënkryetar këshilli u zgjodh z. Xhevit Nofulla, po nga PS. Ndërsa anëtar qarku: Shkëlqim Barçi, koalicioni i majte, me 9 vota, kundrejt Xhemal Purës, me 6 vota. Gjatë mbledhjes pati debate të vogla dhe kërkohej më tepër korrektësi nga anëtarët e PS. Pretendentët për poste në administratë ndodheshin në koridoret e shkollës, duke u bërë kështu të pranishëm në këtë mbledhje, por në fund rezultati, me sa duket, ishte mjaft i këndshëm dhe pa ankime nga të dy palët.

BORA SHAHINI

ILIA MANI BËN BETIMIN PARA KËSHILLIT TË KOMUNËS VELÇAN

Z. Hasim Elezi u zgjodh kryetari i ri i këshillit të komunës

Në praninë e 13 anëtarëve të këshillit, ku shumicën e kanë të majtët, kryetari i rizgjedhur i komunës Velçan, Ilija Mani, ka bërë betimin, për ta qeverisur edhe katër vjetë këtë komunë, deri në vitin 2015. Në këshillin e komunës Velçan bëjnë pjesë këta persona: Shpëtim Lato, Bujar Shuli, Ali Elezi, Petrit Hyko, Hane Çela, Besnik Çela, Anesti Biba, Flori Belegu, Shendet Çela, Kadri Gjona, Hasim Elezi, Flamur Biba, Sava Mokreri. Pas votimit, ku PD dhe PS bashkoi votat, pasi raundi i parë doli 6 me 6, ndërsa njëri abstenoj, kryetar i këshillit të ri u zgjodh z. Hasim Elezi.



KROI ÇETËRË PRET MYSAFIRË NË ÇDO KOHË

Nga Zenun FERRO

Kroi Çetërë, është rregulluar nga bullgarët në vitin 1916, me katër puse, mbi dy metra të thellë, në vazhdim të njëri pas tjetrit. Duke pasur katër puse u quajt nga bullgarët "Çetirje", kështu i thonë katrës në gjuhën bullgare dhe më vonë nga banorët e fshatit Slabinjë është shqiptuar "Çetëra,, (Zenun Fero, "Slabinja jonë Monografi Tiranë 2005 faqe 170). Çezma e Çetërës plotësonte kërkesat me ujë të pijshëm fisin Fero, Balliu, Bego, Sinani e tjerë, gjithë fshatin Slabinjë në raste në thatësira të zgjatura. Rrugët që të çojnë te kroi janë tre, rruga e Ferove, Ballive, dhe një nga lart fisi Balliu. Këto rrugë ishin shëtitja e banorëve, gjatë ditës, dhe të shumta gjatë mbrëmjes, me buljera në krah dilnin gra e vajza për të mbushur ujë në krua. Gjatë rrugës, dhe në krua takonin udhës shoqe e flisnin gjatë e gjërë. Dita ishte e lodhshme në fshat, e ato biseda në mbrëmje ishin një pushim e një argëtim. E ndërsa dielli perendonte e hëna delte, kroi i mbushte buljerat me ujë një nga një e t'ue kënduar. Secilës vajzë e secilës grua i këndonte nga një këngë të vëçantë, përse kroi të tërra i

njej. Vajzat kroi i njej të vogla e i pa dalngadalë t'ue u rritë, gratë i njej nuse e i pa dalngadalë t'ue u plakë, kroi i qetë, mban kujtimet e të gjithë fytyrave. Kroi në heshtje të lehtë i këndon gjithkujt këngën e mallëngjyer të kohës së kaluar. Të shumtit kalonin habitshëm, shuenin etjen, mbushnin buljerat e nuk i dëgjonin. Kjo, ndoshta, ishte më mirë për ta. Kënga e kroit shëndrohet në gëzim. Aty bëheshin gjithë bisedat e ditës, mbyllej dita për disa llogje të fshatit. Dita e re fillonte prapë te kroi. Ai priste e përcillte njerzit, u shunate etjen. Ai është në mëndjen e gjithë banorve, nga i vogli e te i madhi ku edhe kanë migruar e emigruar. Kroi Çetërë jeton në mëndjen e njerëzëve:

Ai vazhdon të nxjerrë ujë, pret njerëzit, të rinj e të vjetër. Pret banorët që vijnë nga Amerika, nga Evropa, nga Ballkani e nga gjithë Shqipëria. Ata qëndrojnë përballë, kroit e sjellin ndërment kujtimet, që vijnë rrjedhshëm. Mirëupafshim kroi Çetërë, ne do të vijmë prapë. Vazhdo të rrjedhish ujin më të mirë në botë. Analizat i ka më të mira, ai ka rritur breza të tëra. Kroi nuk i "harron,, vizitorët, edhe vizitorët nuk e harrojnë kroin. Djentë i njej të vëgjël, e i pret burra, vajzat i njej të vogla, e i pret nuse e plaka.

Udhëtari francez Viktor Berard, shënime për Qukësin e 1863-shit

Nga Zenun FERO

Viktor Berard, një nga shkrimtarët më të njohur të Ballkanit, në vitin 1861, ka vizituar Shqipërinë. Francezi Viktor, shënimet e këtij udhëtimi në Shqipëri i botoi në librin që do të botonte, ky vjen në Korçë, më 1863 me titullin Turqia dhe helenizmi konteporan, kur kapituj, të veçantë u kushtohen edhe shqiptarëve.

Berardi ishte kryetari i komisionit të Politikës Jashtme të Francës dhe njohës i hollë i historisë. Ai viziton Shqipërinë, nga Durrësi vazhdon udhëtimin e tij drejt Bitolës, (Manastirit) të Rumelisë (Maqedonisë). Nga Vlora, kishin gjetur dy shqiptarë që do të shoqëronin për në Maqedoni, duke u siguruar për udhëtimin dhe katër muaj.

Një nga shoqëruesit quhej



Viktor Berard

Abedin i shkathët, kishte qylyfin e kuq mbi kokë, me uniformë blu. Shoqëruesi i dytë ishte Kosta, ishte suliot, ishte veshur me fustanellën e tij të bardhë. Viktor Berard ishte nga Jula malore e juglindjes e Francës.

Viktor Berard vizitori Durrs-

in, Kavajën, Peqinin, Elbasanin në maj gusht të vitit 1861 dhe u nis drejt Qukësit, e Ohrit.

Francezët, të ndjekur nga Abedini dhe suljoti Kosta, humbasin në luginën e ngushtë, ku re të mëdha kanë filluar të grumbullohen e gjëmojnë. Karvani nixton drejt shpatit me shpresë të arrijmë në muzg në urën e famëshme "Ura e Beqarit" ku ka një han dhe mund të kalojmë natën. Më së fundi, në buzë mbrëmje ata pikasin shelgjet dhe ahet rreth urës së vjetër, në cep të të cilit ngrihet hani. "Një burim gjigand uji dilte midis aheve dhe atyre rrënojave antike. Ndoshta dikur romakët ndalonin këtu me kuajt dhe karrocet e tyre që të gjenin pak preheje". Kur ngjiten në han, hanxhiu ka një fytyrë të trishtë pasi, siç u thotë ai lepuri i vetëm që i kishte mbetur, i kishte ikur mes

këmbëve dhe ishte zhdukur, e tani miqëve s'kishte çfarë tu jepte për të ngrënë. "Një fqinjë e hanxhiut, -shkruan Berard, -me dy kobure në brez, erdhi dhe na shiti qumësht. Edhe fëmijët e saj mbanin pushkë. Gjithë natan stuhia ulurinte në gjyken e lumit. Dërrasat e asaj foleze të vogël, linin të frynte era e furishme, e cila atë natë na la pa gjumë. Në qiell, yjet që drithëronin, ishin gati në të shuar. Lepuri i hanxhiut nuk na solli ndonjë andrrallë tjetër..."

Të nesërmen, Berard dhe miku i tij francez largohen duke lënë pas "Urën e Beqarit". "Abedini vazhdon me atë të fatalizmin e tij të qetë dhe me atë këngë të Ali Pashës dhe tri korbat e Sulit: "Tri korba, tri korba, kanë kaluar/tri korba kanë kaluar nga malet e Sulit/Tri korba mbi malet e Suli-i-i-i-t " Këto janë tri vargjet e një tragjedije

prej 200 vargësh. Por ka një javë që Abedini e ka filluar këtë këngë dhe ska shkuar më tej se këto tri vargje. Ai rrudh ballin mbyll sytë dhe çfryn nga hunda atë dhimbje, për të nxjerrë këtë këngë vaji pa fund..." Rruga e tyre vazhdon drejt, anash luginës plot thepisje dhe hanit të Xhyrës një stacion karvanesh prej 150-200 shqiptarësh. Më pas marrin drejt Qukësit, ku në burimet e qytezës madhe, "gratë me këmbët zbatuar dhe gjinjte që u varen lajnë teshat". Atje ata takojnë Jankon, një shqiptar të çuditshëm, që dinte gjuhët e huaja dhe kishte shërbyer si "kavas" gjer në Mesopotami, dhe pas një ngjarje të hidhur ishte kthyer në shtëpi. Më së fundi, karvani i afrohet Ohrit, që nderet tutje në një tis mjegulle. Abedini dhe Kosta i shoqërojnë miqtë francezë gjer në Strugë...



www.AlbanianPhotography.net - Robert Elsie



www.AlbanianPhotography.net - Robert Elsie



www.AlbanianPhotography.net - Robert Elsie

Koleksioni fotografik i Gushiqit për Pogradecin

Branimir Gushiqi (1901-1975), ishte nga një familje kroate. Mbaroi studimet në Fakultetin e mjekësisë të Zagrebit në vitin 1926. Në vitin 1945-1947 dhe nga viti 1956, ishte doktor i Fakultetit të mjekësisë në Zagreb dhe doli në pension në vitin 1971. Ishte alpinist i apasionuar edhe pas Luftës së Dytë Botërore, ishte kryetari i shoqatës së alpinistëve të Kroacisë dhe kryetari i këshillit Kroat për mbrojtjen e Natyrës.

Branimir Gushiqi, shquhej edhe si etnolog, edhe bash-

këshortja Marjana Gushiqi (1901-1987) ishte edhe ajo etnologe dhe punoi shumë vjet si drejtoresha e muzeut etnografik të Zagrebit. Ata udhëtuan jo vetëm në Mal të Zi, në Kosovë, por edhe në Shqipëri, edhe para e pas Luftës së Dytë Botërore. Koleksioni i fotografisë për Pogradecin, Korçën, Voskopojën, Leskovikun e tjerë, të Branimir Gushiqit është bërë gjatë vizitës në Shqipëri në vitin 1947. Fatet janë të indentifikuara për Pogradecin, një foto e fshatit Lin në breg të liqenit Pogradecit (1947) qerre me qe në liqenin e Po-

gradecit, (1947), kisha e Shën Kollit Voskopojë (1947) teqe, jug (1947) e tjerë. Në periudhën 1945-1948 Shqipëria ndodhej në një aleancë të ngushtë me Jugosllavinë, gjë sigurisht që mundsoi udhëtimin e Gushiqit në Pogradec. Fotografitë e Gushiqit afrojnë bukuri të rralla të Pogradecit. Këto fotografi janë vënë në dispozicion nga zotit Anton Kaçinari nga Zagrebi dhe zoti Bajtullah Destani të studimeve Shqiptarë (Centre for Albanian Studies) të Londrës.



www.AlbanianPhotography.net - Robert Elsie

SELMAN BLOSHMI DHE KONSULLI AUSTRIAK KRAL

Nga Zabit CUKU

Ideja bazë e thirrjes së kongresit të Manastirit ishte gjetja e një analfabeti kompromisi midis tre palëve ekzistuese, Frashërit, Mjedës, dhe Bashkimit. Ideja e një kongresi për të vendosur për një analfabet unik për të gjithë shqiptarët kishte lindur që në vitin 1905, kur P. LLAMBI propozoi të bëhet një mbledhje e përgjithshme për analfabetin, në Trieste, Bukuresht apo në një tjetër vend. Kjo u vendos të bëhej në qytetin e Ma-



Kral, konsulli austriak në Shkodër

nastirit dhe organizimi ju besua klubit Bashkimi të këtij qyteti me në krye Fehim bej Zavalinën. Vendimi për thirrjen e kongresit u muar më 21 gusht 1908, dhe në shtator të 1908 u arrit një marrëveshje me tri porteve shqiptare të analfabetit (Toskëve, Mjedës dhe Jezuitëve), të cilët nën ndikimin disavjeçar të konsullit austriak Kral, kanë rënë në një ujdi që të zgjidhin problemin e analfabetit me një analfabet kompromisi. Në vitin 1908, një përfaqësues i toskëve, Nuçi Naçi, është vendosur në qytetin e Shkodrës me qëllim rakkordimi në mes palëve që qytetin ver-

ior. Perandoria Austro-Hungareze kishte interesat e saj politike për arrijmë patjetër të një analfabeti. Ajo kishte financuar gjithë përgatitjet, udhëtimet, akomodimet, e antarëve, si dhe tërë punimet e kongresit të Manastirit dhe Komisionit të Analafabetit. Ajo kishte ngarkuar Selman Blloshmin për këtë qëllim. Më 20, nëntor 1908 u vendos për analfabetin e përbashkët. Koha provoi se vendimi i marrë nuk ishte më i miri i mundshëm. Në asnjë dokument nuk thuhet se vendimi u votua. Asnjëri nuk ishte i humbur, kurse të gjithë palët dolën fitimtarë. Në kongresin e Manastirit, në vitin 1908 mori pjesë Hajdar Blloshmi, nga Bërzeshta,

ndërsa në vitin 1909, Selman Blloshmi ishte delegat në kongresin e Elbasanit, i cili vendosi themelimin e Shkollës Normale të atij qyteti. Në fillim të shekullit të 20-të Shaban Blloshmi nga Bërzeshta solli abetaret e para të gjuhës shqipe në trevat e Komunës Qukësit dhe të Mokrës. Në Mokër u përkrahën vendimet e kongresit të Manastirit për vendosjen e shkronjave latine në analfabetin e gjuhës shqipe. Konsulli austriak në Manastir në relacionin shkruan se " Po të kishte patur mësonjës, shumë katunde do të kishin hapur shkolla me kokën e tyre, si Bërzeshta, katundi më i rëndësishëm i gjithë asaj zone.

Një fundjavë në bregdetin me pisha të Divjakës

Nga Koço Pihoni

Thonë se “sa të men dohen të mençurit, me budallallëk njerëzia mbarojnë më parë punë”. Kjo gjë është më se e vërtetë, përgjithësisht kështu ndodh kur bëhen shumë hesape për të organizuar ndonjë aktivitet që merret shumë seriozisht, shpesh ngelen të zhgënjyer nga ajo që mendohej e pritej të bëhej. Ndryshe ndodh me aktivitete të vendosura në çast, mbase kjo është dhe arsyeja që thuhet shpesh, rasti është Mbret. Kështu ndodhi edhe më këtë udhëtim të këndshëm në ekip që ndërmorëm, siç e shkuam për t’u bërë ne atje “kontroll” të befasishtëm, atyre miqve të vjetër, pa i njoftuar paraprakisht për atë shkuarje nga ne. Ekipi jonë kishte në përbërjen e tij pesë “lojtarë, trima të çartur”. Me detyra e grada të përcaktuara si më poshtë. Kapiteni e përgjegjës i këtij ekipi ishte z. F. Çollaku, organizatori e sebeçiu i këtij aktiviteti. Person kryesori i mirënjohur e shumë i mirë pritë në këtë destinacion turistik. Tjetër personazh i dorës së parë, sponsorizuesi i këtij weekendi ishte z. A. Corbaxhi të cilin e falënderojmë të gjithë së tepërmi, duke i uruar mbarëvajtje më të mira në punë për vitin 2011. Lojtar tjetër i federuar në çastin e fundit ishte z. K. Pihoni, ky nostalgjik për atë vendi, mbasi 25 vjet më parë kish kaluar “Muajin e mjaltit” në ish-kampin e pushimit të punëtorëve, atje në pyllin me pisha të Divjakës dhe që ka për detyrë edhe për ta përshkruar këtë Uikend në një shkrim. Ne shkuam e për të parë e për të lënë detyra atyre miqve atje, në prag të këtij sezoni veror, duke përcjellë edhe eksperiencë nga qyteti i një turizmi elitë sikurse është Pogradeci. Për të vazhduar me personazhin më të këndshëm me një trup të hedhur mustaqe përdredhur z. A. Sokoli, dhe personazhin e pestë “Pilotin” e automjetit “Foristradë”, Olsin, njëherazi dhe bodigardi i këtij ekipi simpatik, me në krye komandant Rapon, që nuk pranonte në këtë ekip, pjesëmarrje shoqesh. Në bagazhin e mjetit, ndodhej një armë gjahu çifte, 10 litra verë buti e 1 liter raki rrushi “Muskat” Pogradeci. Nisja u bë në orën 12.00 dhe u mbërrit në destinacion në orën 14:30 të asaj dite mbasi u përshkuan 180 km. rrugë

Mbërritja në destinacionin turistik kërkonte të kalohej e një pengesë që kishim përpara, “Trau i doganës” atje u bë dhe pagesa e parë dhe e fundit nga ana jonë e atij udhëtimi 200 lek, vleftë kjo që u përballua nga kapiteni ynë i ekipit z. F. Collaku i cili për gjithë kohën ishte “Qoshe mbajtësi” i vendit përpara në atë udhëtim si dhe kudo. Më pas makina vazhdoi rrugën dhe ndaloj vrapin tek Bar-Restorant – Hoteli me pronar mikun e kapitenit tonë z. F. Collaku, z. Harallambi i ndodhur atje në atë cep të pyllit me pisha,



përballë atij Bar –Hoteli ndodhej bregu pa fund i rërës 500 m e më pas detit pa fund, ku ne pasi mbërritëm e zbritëm nga mjeti, pasi u ç’mpimë nga këmbët, dhe u mbushëm me ajër, nga ai ajër i pastër u pritëm më pas nga i zoti i bujtinës i cili na uroj mirëseardhjen dhe më pas, pasi pimë disa gota na u shtrua një drekë “Banket” do thoja me lloj e lloj gatime peshku, levreku, koce, qefulli e lloje e soj ngjash të freskëta të gjuajtura atë ditë në lagunë si dhe fruta deti e plot barishtore, të shoqëruara me Verëra klasi, nga ato që çuam ne dhe nga vetë i zoti i lokalit. Më pas, agjenda vazhdoi me një shëtitje më këmbë në breg det dhe bërjen më pas të një vizite, tek një miku i vjetër i Kapiteit tonë, z. Petrit Nallbani, ish kampion në sportin e boksit në kohën e merumit, i cili më pas kish kaluar shumë vite burgim politik, ku kish qenë bashkëvuajtës me të ndjerin Qani Collakun, kjo ishte dhe arsyeja e kësaj miqësie të më pasme familjare. Z. Nallbani kishte një lokal të thjeshtë në një ambient pozicional me sipërfaqe të bollshme afër bregut, ai po punonte për të përgatitur ambientin, duke lyerjen e bërë shërbimet e duhura për sezonin verë 2011. Ishte njeri i vuajtur por njeri shpirt mirë e zëmër flori, ai i afrojo dhe e ftoj F. Çollakut ta bënte bashkë pronar dhe bashkë punëtor në atë biznes turistik. Në këtë ambient ishim ne, kur u telefonuam nga dikushët Neziri e Fatos Jolla, ku na thuhej se priteshim në një bar restorant aty pranë për të përshëndosur e pirë një kafe. U përshëndetëm me Petritin e u nisëm e shkuan tek vendi i ndodhjes së shokëve mikpritës, prindërit e tyre ishin të ardhur në vitin 1947 nga Jolla e Mokrës tonë që edhe pas 65 vjetësh, ata na tregojnë se shkojnë në sebepe edhe sot në Jollë, Tallë, Losnik, Slabinjë e më shpesh në Pogradec.

Ftesa për të pirë “një kafe” tek bari i z. Bujar Tullaci, na doli si ajo “ferra e vogël” e të madhit Tano Banushi, ku ajo kafe u kthye në një ziafet, ku luajti e qeni i kallanxhiut thonë andej nga ana jonë. Nuk vonoj dhe u nxuar nga frigoriferi një shishe me raki rrushi të zierë prej tyre

vetë dhe më pas pjanca me ngjala të pjekura e lloj lloje peshqish të zgjedhur të gjuajtura prej tyre në lagunën e Karavastasë, mbasi ky ishte dhe profesioni i tyre atje, krahas punëve në bujqësi në tokat shumë pjellore që kishin përfutur, kujtoj se ky nder e ky hatër. Që na u bë, ishte për nderin e vendin që kish bërë e lënë Kapiteni jonë ndër vite e vite miqësi me këta njerës të mirë bujarë e njëheras me gjak nga anët tona nga fshatrat e krahinës e Mokrës. Biseda vazhdoi e u kthye në një gosti ku rakisja u pi sipas traditës të krahinës tonë, duke u bërë Dolli nga të zotët e vendit, zotërinjtë Barjami e Neziri e ku më pas, Dollia e mikut u ngrit nga komandanti jonë, “legjendar” F. Çollaku më sekretar në atë dolli K. Pihonin “Uratën” ku në Dollin pinë disa gota dhe për shëndetin dhe ju urua fitor në zgjedhje, kandidatit për Kryetar në Bashkinë e Divjakës me damar nga Llënga e Mokrës, z. Kokoneshi e doemos për tërë shokët e miqtë të ndodhur atje e për soj e fis e “degë e lis” që ata kishin. E më pas, për ta kompletuar atë muhabet me shumë këngë të kënduara nga “Tuj, tuj, tuj. pulat e detit” e deri tek, “Ku mërzen cja-pi me zile” e të tjera këngë qytetare për ta vazhduar e mbyllur atë muhabet kur ora vajti 12.00 e natës, për t’ju lenë radhën pas një ore të këndonin gjelat e fshatit. U ngritëm e shkuam tek lokali ku kishim prenotuar hotelin, atje na priste miku e ustai jonë Harallambroja i cili kish përgatitur darkën dhe përmblylljen e asaj mbrëmje të cilën unë mendoj duhet quajtur, një darkë pas atyre “pushime aktive” me mezëra e pije Vino. për të kaluar, më pas në asaj orë të ngelura për gjumë tej asaj nate, atje ku bëhej gjumë prej shqerkash, për shkak të atij pyllit me pisha dhe Ozonit O3 të bollshëm e asaj qetësie absolute që mbretëronte atje. Në orët e mëngjesit rreth orës pesë “Uratës” ju faneps në ëndërr Shën Thoma, dora vet, ai, më pyeti në ëndërr mua, Uratë si ja kishim kaluar, si ju pat vajtur ajo dita e ajo darka e saja dje? Unë, “Urata” ju përgjigja Shën Thomait me dorë në zëmër, duke i

thënë: Si jo më mirë. Si ajo Dreka e përcjelljes nga kjo dynja e të ndjerit usta Janit, në të kujtohet, o Shën Thoma, Atë e nderoj Zoti si jo më mirë. ! Kujtohet edhe sot si ju pat thënë aso kohe Papa Ndoni, njerëzve të pranishëm në atë drekë përcjellëse të shtruar për usta Janin. Më ardhka mirë, mu bëka qejfi o Uratë, kështu më ju lumtë, se ashtu ju do Shën Thoma, kisha merak, por tashti që dëgjova nga goja jote o shërbëtor i Perëndisë, tashë jam vërtetë i kënaqur dhe i qetë dhe unë.

Dhe u zhduk Shënijti ! Sa kaq unë hapa sytë, por u befasova se mungonte Komandant z. Collaku u shqetësova si u bë vallë?! Mos e mori Shën Thomaj me vehte ! U ngrita i alarmuar i telefonoj pronarit Harallambos i cili nuk vonoj dhe vjen në dhomë, ku unë i them se nuk mora vesh si u zhduk shoku e miku juaj pa lënë gjurmë ? Ai shkon e vjen në çast me një palë Dylbi prej kapideni Vaporesh, si teleskop me të cilat mund të shihje dhe bregun përtej detit, me ato kontrolluan nga ballkoni i godinës, gjithë bregun ku dikur kish zbarkuar Xhevdet Mustafa, Ne në atë mugëtitë e mëngjesit e gjollitën me dylbi Kapitenin tonë i cili shëtitte anës bregut e meditononte me valët e detit të cilat dukeshin sikur e përshëndesnin e sikur bisedonin me të, sikur i thoshin ato Valët atij? se ju kishite munguar, dhe e lutnin të rinte disa ditë midis bregut e valëve të detit ! Usta Llambros, unë Urata, dora vetë i them të shkojë të na bëjë kafënë dhe së bashku atje në ballkon pimë dhe nga një gotë Raki në shoqërinë e asaj kafeje në pritje të ardhjes shëndoshë e mirë të Kapitenit tonë. Më pas Llambrosia i rrëfen z. Collakut për sa i kish thënë Urata gjatë përrjes me të, të kafesë dhe më pas në prani edhe të shokëve të tjerë, ai i afrojo Uratës, një mjedis në katin e kreut për ta bërë Kishëzë!, ku Urata të nxjerrë Meshën e së Djelës të bekoje e kungojë duke ja u falë mëkatet, mëkatat e mëkatave të gjora për t’i kthyer dhe ato në rrugën e drejtë të Zotit. Më pas usta Llambrosia përgatiti një mëngjes ekstra, makarona me fruta deti e plot gjëra të tjera. më

pas ekipi me të pesë trimat e çartur u përshëndet shumë miqësisht me të zonë e shtëpisë për ty larguar, për andej nga patën ardhur, se jeta edhe ndarje ka, duke e falënderuar dhe premtuar se do ktheheshim përsëri një ditë. Më pas makina nisi vrapin për të ndalur dhe për tu përshëndetur tek një tjetër bar restorant i ri, ku u pritëm me buzëqeshje e dashamirësi nga miqtë tanë dhe pronarja e atij lokali e cila ishte një zonjushë shumë e bukur dhe e nderuar. Mësuam se ajo ishte zonjusha Dhuratë një zonjushë bjondinë lozonjare, me trup si selvi, me ata dy sy të kaltër e ato flokët deri në bel të gjata, ngjyrë thuasë të arta ! Atje u mblodhëm të gjithë si ekip, tok me shokët e miqtë e natës së kaluar. Ajo zonjusha na falënderoj duke na thënë se kishim qenë të parët që kishim shkelur për këtë sezon të ri, paçi këmbë të mbarë. . Ajo u tregua shumë e ngrohtë e miqësore me ne, kjo ishte dhe arsyeja që Kapiteni jonë t’i thotë e ta pyesë atë. Si i shkonin punët dhe se çfarë dëshironte e lutej për këtë sezon të ri veror ? Ajo na tha se dëshironte të ecte puna mbarë gjatë këtij sezoni, se me shëndet shpyqyr Zotit mirë jam. Kaq i duhej kapitenit tonë i cili dhe në fakt është diplomuar për avokaturë. Kaq material i duhej prej asaj, se të tjerat, zgjidhjen si do ta ndihmonte e çfarë duhet të bënte ajo, do t’ia sugjeronte ai !

Po si, më thoni ju lutem ? Ja e shikoni këtë zotërinë, ? Po e shikoj tha ajo. Ky është njeriu i Perëndisë, ka dhunti çudibërëse nga Zoti vetë, Po të dojë ai, Po t’ju bekoje e kungojë juve ai, puna ka për tu shkuar “Grurë e thekër” kjo është gjëja më e lehtë që juve kërkua nga ai. Sakaq ajo zonjushë e bukur u drejtua nga unë me përlulesi “Uratë” më thotë janë të vërteta këto fjalë ? Po i thashë. Unë, do bëj një përjashtim për Ju ! Në pa mundësinë e një vendi të shenjtë, Kryqit e librit të shenjtë Ungjillit, si dhe veshjes së Uratës Rasës e Kamillafit. Por për ju është një kusht, duhet të keni besim të plotë ne Zoti e tek Urata si shërbëtor i Perëndisë. Këto fjalë mjaftuan që ajo zonjushë e bukur, Vjen tek unë e më puthë tre herë dorën më buzët e ballin e saj prekë Më pas unë u ngrita më këmbë në ndërrim të asaj dhe fjalëve që do predikoja, do ta bekoja unë, Në emër të Zotit, Birit e Shpirtit të Shënjtë Ky ritual i “Bekimit” dhe puthjen e saj në ballë nga Urata u fotografua nga z. A. C. për ta ilustruar dhe këtë rrëfim. Më pas ju tha zonjushë nga “Urata” Mos harronte të puthte në të dyja faqet në shënjë reapekti Kapitenin tonë, “Legjendarin” z. F. Collaku porosia vajti në vend me shumë kënaqësi prej saj gojshes së re e shumë të bukur të ndodhur në atë pyll me pisha.

Kështu përfundoj ai Uikendin, Më pas duke u përshëndetur shumë miqësisht makina mori rrugën drejt bazës së nisjes në Pogradecin tonë turistik Mirësetëvini !

SIRENAT E LIKNIDËS

A ka sirena në Liknidë?

*Thonë s'ka, ato janë vetëm në mitologji.
Por thonë dhe ka, se herë-herë, nëpër gjelbërim
të brigjeve të liqenit, pranë ujërave kristaline,
ku s'ka njeri, dëgjohen ca lloj fishkëllimash,
që s'janë të botës sonë.
Se si janë ato fishkëllima...*

Nga Kristaq NANUSHI

Kishte mbetur edhe një orë natë. Peshkatori shtyu gjemninë në liqen dhe kërcëu në të. Llacka e valës, që lëpinte buzën e bregut, zuri të puthte barkun e gjemisë.

U dha e u dha lopatave për thellë. Yjet thërmonin ar mbi liqen e mbi tufat e shpendëve të egër që përgjumeshin me kokat kthyer mbi kurriz e futur nën krahë. Dëgjohej vetëm shshst-shshst e lopatave në ujë dhe ndonjë krakitje rose.

-Natë e qetë, tha me vete peshkatori, - e mbarë për gjah.

Shkoi ora dhe majat e Malit të Thatë po sillnin dritë. Qielli u çyçzua. Peshkatori kërkoi një shenjë nëpër ato maja, pastaj një shenjë tjetër prapa tij, në Gur të Kuq, dhe lëvizti varkën ca më tej. Atje gjeti një pllutë me zhuka balte, që mbante mbi ujë cepin e litarit të vlakut. Cepi tjetër lidhej me pllutën tjetër, njëqind pashë më tej.

-Mirë, - tha, - tani është koha.

Ishte koha kur korani, i urtuar nga nata, dilte nga viri për të ngrënë mëngjesin në vezhdën me pllashica. Por aty, midis dy zonave, vezhdë e vir, pesëmbëdhjetë pashë thellë, rrinte nderur vlaku...

-Le të dalë mirë dielli, - mendoi.

Dhe nxori nga trasta napën e bardhë, ku kishte mbështjellë mëngjesin: një gjysmë çyrek, ca thela krapit të tharë, djathë, një qepë dhe ca dardha lëngje. Nxori dhe calikun me verë. Dhe zuri të hante.

Ca nga ca dielli doli dhe mbushi liqenin gjithë xixëllima drite. Drejt tij xixëllimat bëheshin të dendura e të forta, sa të merrnin sytë.

U ngrit në këmbë, u shkryth dhe filloi nga puna. Në kishë të gjemisë zuri të tërhiqte e të mblidhte palë-palë vlakun. Nuk vonoi dhe nëpër syze, duke plapuritur rretën, zunë të vinin koranë, lekna, stërfa e ndonjë klen viri. Të hedhur brenda gjemisë ata kërcenin me forcë e stërka.

Duke tërhequr e palosur vlakun, gjemia lëvizte ngadalë nëpër xixëllima të diellit. Si kaloi kështu njëqind pashët, peshkatori bëri dhe palën e fundit të vlakut, vuri mbi të pllutën e fundit dhe vështroi gjahun që vazhdonte kërcente me stërka.

-Mirë, të falem o Zot! - tha dhe mori të kthehej.

Lopatave tani u jepte ngadalë.

Bregu i liqenit nën Kala e Gur të Kuq bleronte nga shelgjet de-

gëvarur në zall dhe kallmi lulexhufkë në ujë. Faqet me vreshta lart dhe bregu me gjelbërim poshtë qenë mbytur në dritë e paqe. Në rrugën anës bregut rrallë shkonte ndonjë kalimtar. Midis vreshtave, lart, nëpër shkozë e dushkë e frashër, rrallë dukej ndonjë bari me ca pak bagëti. Dëgjoheshin vetëm tringëllimat e zilkave përzier me tingujt e pizgave, glyrave, dudukëve, bilbilave, të bëra nga lëvoret e bisqeve të lëngëzuara të gështenjave. Mbi zall të bregut peshkatori deshi të çlodhej pak, para se të hynte në qytet. Dhe afroji gjeminë, por aty, te brezi i kallmit, u shtang.

Një fishkëllimë e ëmbël, e bukur, ndjellëse, dehëse ngrihet diku aty. Ishte një melodi si nga origjina e botës. Bëri më afër gjeminë dhe ç'pa? Midis kallmit e bregut, gjysma nën ujë e gjysma mbi ujë ishte një gur, rënë nga Kalaja kushediçkur. Pas tij rinte mbështetur një vajzë çuditërisht e bukur. Rrinte dhe fishkëllente, fishkëllente dhe lonte me flokët e verdhë e të gjatë, që trupin lakuriq ia mbulonin deri në mes. Nga mesi e poshtë trupi fshihej në ujë.

Peshkatori u mek. Ç'të ishte kjo? Në liqen ç'nuk kishte hasur: peshq të panjohur, kafshëza të papara, shpendë të rinj, mirazhe ngjyrash, dallgë të frikshme, furtuna të tërbuara, gjeratoret e vdekjes, ëndërrime me mrekulli, imazhe të lbyrura në arin e hënës dhe në vezullimin e diellit... Po kjo, ç'ishte kjo? Njeri jo. Se ishte tepër e bukur për të qenë njeri.

Kishte përballuar shumë dallgë të liqenit dhe dallgë të fatit, po këtë dallgë nuk e kishte provuar. Dhe nuk po e duronte dot. Një afsh u ndeh nëpër fytyrë, furtunë e dallgë u ngrit në shpirt. Sytë i mbetën mbi të dhe u deh. Dehja iu përzie me kërsheeri e dëshirë. Çudi kjo dehje e tillë, pa fjalë, pa prekje, pa puthje! Mori të fliste, zë s'i doli. U shtrëngua të thërriste, zë prap s'i doli.

Peshkatori u arratis nga vetja.

Fëshkëllima e ëmbël e vajzës ndezi zërat e natyrës. Lumi pranë, që sillte ujë bore nga Salselisha, këngëzonte i gëzuar. Zogjtë e shumtë, fluturakë e zhytarakë, shtuan pingërimat e tyre. Përmbi ta dëgjoheshin bilbilat, zbritur aty nga vreshtat lart. Një bilbil gjyjar lante krahët në ujë e grishte. Mbi gurickën e pastër të zallit një cinxull tundte bishtin dhe kërcente pa pushim.



"Sirenat e Liknidës", ilustrimi nga Anastas Kostandini (Piktori i merituar)

Një gushëkuq doli nga nënferra dhe shihte i hutuar. Kurse nga kallamishta doli një rosë e shpenduar. Dukej që sapo kishin të bërë dashuri. U ngrit në bisht, rrahu krahët dhe, duke tundur bishtin, u fut prapë atje ku qe...

Mes diellit dhe gëzimit vajza mbi gur nuk e mbajti më veten. Shtoi fishkëllimat e ëmbla, kërcëu në ujë dhe zuri të sillej rrotull gurit. Ajo nuk ecte. Ajo notonte me shpjesën e trupit brenda ujit. Mbi kokë të saj zogjtë u mblodhën në valle. U bë valë e vallëzim. Gjithçka u ndez në gëzim, po ndezullia e zogjve s'mbahej.

Peshkatori u përmend. Vajzën e pa me një brerore drite mbi kokë. Pastaj pa ca rreze të bardha që pas shpatullave të saj u pendëluan në flatra.

-Mos është engjëll? - pyeti veten peshkatori.

Vajza u zhyt e gjitha nën ujë. Sipër saj, mbi ujë, u mblodh një bashkë xixëllimash përshkënditëse. Vajza nën ujë e xixëllimat mbi ujë, zunë të vallëzonin rreth gurit. Mbi rrathët e valëve silleshin rrathët e xixëllimave, mbi rrathët e xixëllimave silleshin në ajër rrathët e zogjve.

-O zot, - tha peshkatori, - ç'është kështu?!

Ndjeu dëshirë të afrohej, e ndoshta, të hynte në valle. Po duart s'iu urdhëruan të kapte lopatat. Deshi të fliste, zë s'i doli. U shtrëngua të thërriste, zë prapë

s'i doli. Atëherë u frikësua.

-Mos është xhind? - pyeti përsëri veten.

Kishte dëgjuar që xhindet shfaqeshin në lloj-lloj formash si: E Bukur e Dheut, E Bukur e Ujit, apo Floçkë, apo Gërshetëzë, si kafshë të papara, si dhi me një bri, si zog i zi, si shtëllungë tymi, si... Dhe të ndillin, të joshnin, të dehnin, të kënaqnin... Pastaj të merrnin fuqinë, të merrnin sytë, të merrnin mendjen... Pastaj të vdisnin.

Cila nga këto po ndodhte?

Peshkatarit iu soll nëpër sy jeta e jetuar dhe nëpër mendje jeta e pajetuar. Ishte në mesmoshë. Me frikën iu përzie keqardhja.

Sakaq, vajza e bukur doli nga uji dhe kërcëu e gjitha mbi gur, këtë herë në majë. Tani peshkatori pa që gjysma poshtë e saj, s'qe trup e këmbë, po një bisht peshku. Një bisht i madh, i argjenditë, që ndritte në diell. U trondit. Fikthi në fyti shkante lart e poshtë dhe u gëlltit disa herë, edhe pse gojën e kishte të tharë.

-Xhind do të jetë?! - tha, po

Shënim: Në numrin e kaluar është bërë, pa dashje, një gabim shtypsi në emrin e autorit të legjendës. I kërkohet ndjesë z. Kristaq Nanushi!

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabiti ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"
Istref Haxhillari, Zabiti Çuku, nënkryetarë të shoqatës
Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

www.poradeci.com/mokra

prapë ndërroi mendje. - Jo, jo, se xhindit nuk i bëhet brerore drite mbi kokë, as krahë rrezesh në shpatulla. Ato u bëhen engjëjve. Të jetë engjëll? Po engjëjt janë lart, në parajsë. Me krahët e tyre zbresin dhe në tokë, po prapë ngjiten lart, në qiell. Ç'i duhet një engjëlli bishti i peshkut në qiell?

Ashtu, i papërcaktuar, i dërrmuar nga emocionet, s'diti si të bënte më. As si të mendonte. Më mirë që mbeti aty, fshehur pas kallmit dhe s'iu shfaq. Ku i dihej? Aty më mirë!

Shkoi dorën ballit, kishte djersë.

Por peshkatori nuk diti, gjithashtu, që një hobe, diku, u vërtit e u vërtit e u vërtit, dhe hodhi aty, në mes, një gur balltok sa një pjepër. Kori i zërave të natyrës u çorr e klithi si në kataklizmo. Stërkalë e madhe u ngrit, zhurmë e madhe u përhap. Vajza, që s'qe vajzë, u hodh e u tret në ujë. Peshkatori ia pa dhe njëherë trupin lakuriq dhe bishtpeshkun që përndriti. Këto i mbetën në sy.

Kur e mblodhi veten, s'e mori vesh sa kohë kaloi. Po ca fuqi mori, sa për pak rrugën e mbe-tur deri në qytet. U nis.

Doli në breg, atje ku u nis që pa gdhirë, dhe tërhoqi gjeminë.

Gjindja u afrova të shihje gjahun. Peshkatori mendjen nuk e pati as te gjahu i mbarë, as te vlaku që duhej tharë. Zuri të tregonte atë që kishte parë.

E tregoi aty, në shtëpi, në shesh, kudo. E tregoi atë ditë, e tregoi ditëpërditë.

Ca e besuan, më të shumtët jo.

Të paktët, që besuan, e treguan si ngjarje të vërtetë. Të shumtët, që s'besuan, e treguan si përrallë, si ëndërritje, si gënjeshtëri, si lajthitje.

Më vonë, buzë Liknidës, zunë të vinin rrëfime të tilla dhe nga ujëra të largëta. Rrëfimet shkolinin e vinin. Nëpër rrëfime, këto vajza të bukura me bishtpeshk të argjenditë i quajtën sirena.

Pra, a ka sirena në liqen?

Thonë ka, se ka rrëfija të tilla.

Thonë s'ka dhe këto rrëfija janë trillime, gjenden vetëm nëpër libra.

Po librat thonë se në ujërat e

lumenjve, liqeneve e deteve kanë

jetuar sirena. Sidomos pranë

ujërave të pastra.

A s'është e pastër Liknida?

Në 68-vjetorin e saj

Beteja e Pojskës

Baladë për dëshmorët e Pojskës

Një tym një mjegull duket
Ca krisma ndihen larg
Një tufë trimash sulen
Me shpirt e zemër flakë.

Nga sulen në ballë fare
Një sërë plumbash bien
Prej dorës gjakatare
Shokët na i rrëmben.

U ul nga degët fleta
Gjëkund s'pipëtin
Përgjumur duket jeta
Një botë psherëtin.

Tek re Reshit luani
Të qajmë ne me lot
O Ptoleme Xhuvani
Rënkon e s'ngrihesh dot.

LasgushPoradeci

Nga Llazi TONA

Në afërsi të fshatit Piskupat, mbi rrugën automobilistike Pogradec-Qafë-Thanë, u zhvillua një betejë mjaft e ashpër dhe e organizuar, në mëngjesin e 16 korrikut 1943. Në këtë betejë morën pjesë rreth 120 partizanë të batalioneve të Mokrës, Bërzeshtës e Dumresë, të udhëhequra nga akademiku ushtarak Reshit Çollaku. Luftimet filluan në orën 7 të mëngjesit, kundër një patrulle italiane, me katër-pesë automjete që lëviznin në drejtim të Elbasanit, nga Pogradeci. Pak më vonë u afrua edhe një autobondë, një kamion dhe një veturë e komandantit të artilerisë së korparmatës XXV italiane.

Pas 40 minutash nga drejtimet e Pogradecit, të Përrenjasit, si dhe nga liqeni, fashistëve në këtë betejë u erdhën në ndihmë forca e mjete të blinduara. Komandën e forcave partizane urdhëroi tërheqjen me rregull, gjatë së cilës u zhvilluan luftimet më të ashpra, duke shmangur rrethimin e plotë. Luftimet zgjatën 6-7 orë, fashistët patën rreth 30 të vrarë e të plagosur, ndër ta edhe komandanti i Artilerisë së Korparmatës XXV të Armatës IX. Nga partizanët mbetën të vrarë 10 dëshmorë, mes të cilëve edhe komandanti i forcave partizane Reshit Çollaku. Si çdo vit, edhe këtë 16 korrik u përkujtuam me respekt këta dëshmorë të atdheut që derdhën gjakun e tyre për atdhe, për lirinë e vendit, në ëndrrën e tyre për një "botë të re". Nuk munguan në këtë 16 korrik homazhet, kurora dhe lule mbi monumentin që përjetëson këtë ngjarje të shënuar të Luftës së Dytë Botërore. Kush ishin 10 dëshmorët, që ranë më 16 korrik?

RESHIT ÇOLLAKU (Hero i popullit)

Pushtimi fashist më 7 prill 1939 e dëshpëroi pa masë. Në Akademinë Ushtarake të Modenës së Itali, ai refuzoi



betimin ushtarak, duke u kthyer në atdhe, në Pogradec. Më pas nisët për në Jugosllavi në klubin "Emigranti". Kthehet përsëri në Shqipëri dhe merr pjesë në demonstratën e 28 tetorit 1941. Shkon në Mokër ku krijoi çetën e më pas batalionin e Mokrës. U vra më 16 korrik 1943.

SIRI KODRA

Që në moshën e fëmijërisë del hapur kundër fashizmit, duke grisur fotografinë Viktor Emanuelit III. Arrestohet e më pas lirohet për mungesë faktesh. Kalon në ilegalitet në Elbasan. Është një nga themeluesit e Çetës së Dumresë, duke u bërë zv/komandant i Batalionit.

SPIRO GJIKNURI

Biri i një minatori që kishte punuar në Saint- Etienne të Francës, Spiro Gjikhuri mbaron shkollën e mesme dhe gjen punë në Elbasan. Si njihet me aktivitetin e luftës, hidhet në ilegalitet. Caktohet zv/komandant i kompanisë dhe merr pjesë në luftimet e Pojskës, ku edhe mbeti i vrarë.

KOLI GUSHO

Herët merr pjesë në Luftën me grupet edukative të Pogradecit. Punon për mobilizimin e popullit në luftë kundër pushtuesit. Shtëpia e tij kthehet në bazë të luftës, ku mblihdeshin krerët komunistë të zonës dhe ilegalët. Inkuadrohet në Çetën e Mokrës, ku luftoi përkrah komandantit Reshit Çollaku, me të cilin dha edhe jetën e tij, në 16 korrik 1943.

PTOLEME XHUVANI

Mbas mbarimit të shkollës në Elbasan, regjistrohet në Liceun e Korçës. Pasi mbaroi liceun shkon për studime në Francë. Pas pushtimit fashist ndërpreu studimet dhe kthehet në atdhe dhe inkuadrohet në radhët e lëvizjes antifashiste. Punoi për ndërgjegjësimin e popullit të Elbasanit në luftë kundër pushtuesit. Me armë në dorë ra në betejën e Pojskës.

ALI ARAPI

Ishte dhënë urdhri për t'u shpërndarë në pozicione luftimi. Atje, në mes të fushës së Pojskës

kërciste mitralozi i Reshit Çollakut dhe bashkë me të qëllonte edhe Spiro, Siriu, Ptoleme, Koli, Aliu, Arifi, Petriti, Isufi... Megjithëse forcat ishin të pabarabarta, Aliu nuk e lëshoi pozicionin e tij, derisa dha shpirt në fushën e betejës.

ARIF KUKA

Bashkohet në Pishkash në djegjen e barakave dhe materialeve të shoqërisë "Fer Albania", në djegjen e karabinierisë së Qukësit dhe Polisit. Merr pjesë në luftën e Pojskës, ku ra në luftime së bashku me komandantin.

PETRIT BLOSHMI

Bërzeshta, vatër e luftës për liri lindi edhe birin e saj Petritin. Herët u inkuadrova në luftë, duke marrë pjesë në krijimin e çetës partizane të Bërzeshtës dhe u bë udhëheqësi i saj. Mori pjesë në shumë luftime dhe aksione, derisa dha jetën në luftën e Pojskës, për lirinë e popullit dhe atdheut.

DILLO NEZHA

Që në fillim u radhit në Çetën partizane të Bërzeshtës ku mori pjesë në të gjitha aksionet dhe luftimet e saj. Në luftën e Pojskës u shqua për shpirtin luftarak dhe guximin e tij, derisa sa dha jetën.

ISUF LEKA

Pas vdekjes së babait, së bashku me nënën dhe të motrën, shkojnë në Elbasan, ku lidhet me luftën. Duke qenë në shërbimin e Kuesturës Isuf Leka ndihmoi jashtëzakonisht luftën, duke dekonspiruar mjaft informacione dhe detyra të rëndësishme. Më pas kaloi në radhët e lëvizjes në Çetën e Dumresë dhe në betejën e Pojskës njohu shokun e fëmijërisë, Petrit Blloshmin, e nuk u ndaj prej tij, derisa dha jetën me të.

Lufta e Pojskës është një epike e lavdishme e luftës së dytë botërore në Shqipëri, një ngjarje që përkujtohet me respekt. Gazeta "Mokra", vazhdimisht ka shkruar dhe ka nderuar kujtimin e të rënëve për atdhe, ndaj edhe kësaj here ky është një homazh për ata bij të popullit që nuk kursyen as jetën e tyre për lirinë.



Vëllezërit Bashkim e Zabit Çuku

RAJCA E JONË SHUMË E LASHTË

Poezi nga Bashkim ÇUKU

PËR RRAJCËN HALLEMADHE

O ju djem të Rrajcës sonë:
Asnje çast mos na harroni
se jeni bijët taanë,
veç ku jeni dhe punoni
Vendlindjen tuaj
kurrë mos e harroni

KOSTUMI RRAJCAR
Ky kostumi i Rrajcarëve
Si për burra e për gra
Nuk gjendet në Ballkan
I vetëm kostum i rrallë

E veshin nëpër dasma
Në festa edhe urime
Që nga pleqtë edhe të rinjtë
Se kështu ka qënë traditë

Është i vjetër shekullor
Nga stërgjyshit e asaj kohe
Kësula që e mban në kokë
Floririn e ka me okë

Nusja veshur me të bardha
Bukur bukur shkon si ngjala
E stolitur më së miri
Këmish e bardh me 70 pala

Kur nusja hipën në kalë
Me kësulë e me duvakë
Se dajua e mban për krahe
Me urimin rrugë të mbarë

QË NGA VJEN KJO JEHONË

Se nga vjen kjo jehonë
Veçse ja nga Rrajca e jonë
Rrajca e madhe plot me valle
E vendosur në këto male

Malet tona janë të arta
Edhe fushat me lëndina
Lozin vallet me dauille
Si nga pleqtë edhe të rinjtë

Vallet të bëjnë për vete
Me emocion në vetëvete
E vështirë për ta kërcyer
Se zemra e ka rëmbyer

E kërcenin shumë vite më parë
Ahmeti me Havanë
Dhe Xhelua me Qemalë
Po Kasemi me Sadinw
Dhe tani brezat tanw

Loznin këmbët me ngadalë

Mbi sofër vinin vërdallë
Dhe me fund dollinë e parë
Për Rrajcarët anë e mbanë

NËNA ATJE MUA MË LINDI
Dardha e jonë plot livadhe
Emër vendi është në rrajcë
Vëndi bukur veshur me male
Me mijra vjet hedhin valle

Nëna atje mua më lindi
Tek sheshi dardhës i thonë
Atje piva qumshtin e parë
Veç atje të jetoj

Burimi i ujit shumë i ftohtë
E ka pirë im gjysh në kohë
Atje do të pi dhe unë
Se vendit i dalim zot

Ky nipi nisët e shkon
Tek sheshi dardhës po qëndron
Dritë e diellit dhe e hënës e ndriçon
Vendin e gjyshit e nderon

Atje këndon bilbili
Me manushaqe trandafli
Vend i bukur për njerinë
Vendi pastër për bagëtinë
Në pranverë e në beharë
Lozin zilet duke qarë

O ju djem të Rrajcës sonë
Asnje çast mos më harroni
se jemi bijët tuaj ku jeni e punoni
Vendlindjen tuaj mos e harroni

RAJCA E JONË SHUMË E LASHTË

Ky kuvendi në katund
Me drejtsi, drejtsi pa fund
Në kohë e deri sot e quajmë Rrajcë
Që nga Valthi në Qaf-Thanë

Rrajca e jonë shumë e lashtë
Ka hedhur vallen kudo jashtë
Në të gjithë ato asamble
Vallja e jonë kq e mirë
E drejtuar nga SADIU
Kur e sheh ai loton
Mbi karrocë tani qëndron

Fshati i jonë kaq i mirë
Kërcen vallen dhe në Kinë
Se kjo vallja Rrajcare
Merr gjithmone çmime të para

Në atë rrugë ne të shkojmë
Vallen tonë mos e harrojmë
Ju breza që po vini
Vallen Rrajcare ta përpini

Ritet zakonore në zonën e Mokrës

RITE QË ZBTOHEN NGA LINDJA E FËMIJËS DERI NË MOSHËN KUR KALON FAZA E BEQARISË

Nga Zabit CUKU
Bashkim KRASTA

(vijon nga numri i kalaur)

Bukë vala është përdorur edhe në rastet e cermonive të tjera të fëmijëve. Nga kjo bukë duhet të hante dhe e jëma e fëmijës për të patur sa më shumë qumësht e mos u merrte me sy të keq apo mos e zëjë magjia.

Pas vendosjes së emrit, të jëmën dhe fëmijën e marrin prindrit e vet për të kaluar 40 ditët e lehonës. Kjo ka si zakon besimin Islam që nusja për 40 ditë nuk lejohet të flejë me burrin. Këto cermoni behen për djalin ose vajzë, dhe kanë të veçantat e tyre. Për vajzën bëhen më pak, nuk ndihen shumë, thërrasin në gosti më shumë seksin femëror nuk bëhen doli të medha ose fare, pra ka një farë nënvlersimi. Kjo ka kuptimin se vajzat janë dera e botës, ose "kur lind vajza qajnë edhe trarët e shtëpisë", ose vajza e sapo lindur u thotë prindërve "ju më doni tre ditët e pra se jam e shëmtuar, sepse pas këtyre u bëj unë që të më doni,, e tejra.

Për rritjen e fëmijës rëndsi kishte e ka edhe siguri i djepit (krevati) i cili përgatitej prej dru arre, i bukur i lehtë, me lule e zbukurime të shumta. Nga pjesa ballore e kokës, vendosen një rreth prej druri i bukur ose zgjerohet nga sipër. Këto bëhen më të larta, të bukura me lule e gëdhendje. Kjo lartësi shërben për të mbajtur lart fytyrën, një shami ose maramand, të qëndrisur bukur që fëmija të mos duket kur flen gjumë, mos e ngacmojnë mushkonjat apo mizat, dhe në rast se përmbysen djepi fytyra e fëmijës të mos takojë në tokë. Zbukurimet i përshtaten traditës së zonës, e krahines e trashëgimisë që kanë lënë të parët. Një elemnt që i vendoset djepit për të lidhur fëmijën kur flen gjumë është një dizga (shirit) lidhës, kjo e gjatë mbi 2 m, me gjërsi deri 10 cm. Kjo përgatitet prej leshi të butë me lule e qëndrisur me ngjyra tërheqëse dominon e kuqja. Tjetër element është një shpërgër (batanije) e përgatitur në veqë ose nga fabrika. Ky behet me ngjyra sipas mundësisë, me këtë flinte fëmija deri sa kalonte nga djepi në një vend tjetër për të fjetur.

IV NGRITJA NË KËMBË

Edhe për ngritjen në të fëmijës praktikohen rite të ndryshme. Ato i kushtohen evitimit të frikës së fëmijës në momentet e para për qëndrimin në kembe të tij sa më shpejt për të ecur i pa varur. Në disa zona e krahina, fëmijën e hipnin në kalë. Nga gjyshja ose e jëma përgatitin disa shkarpa si një barrë të vogël e të lidhura. Këto ja ngarkojnë fëmijës, dhe e tërheq për dore tre herë duke e rrethrotulluar nëpër dhomë.

Shkarpat një familjar i thyen ose i pret me sopate duke folur me ze të lartë tre herë, se: "po pres dru e po pres frikë" e c o djale eja një cik", dhe një tjetër e pyet se: "çpo bën aty?- "po i heq frikën e djalit"..... Pas kësaj fëmija lahet ushqehet dhe vendoset në gjumë, barra e shkarpave hidhet në një vend të largët ku të mos duken në errësirë.

V DALJA E DHËMBIT TË PARË

Kush e shikon për herë të parë se ka filluar dalja e dhëmbit nga fisi duhet të përgatiste një dhuratë të mirë për fëmijën si për djalin apo vajzën. Prindrit mund të organizonin edhe një gosti të vogël se fëmijës i doli dhëmbi i parë. Kur dhëmbi del shpejt dhe pa shqetsime tre-



gon se fëmija është i qetë, jo nevrrik, kur ka shqetsime dhe grindet e vonon dalja e dhëmbit tregon se fëmija është kokë fortë.

VI KUMBARIA "NUNI"

Traditë dhe rëndësi e veçantë është edhe ai i qeths "kumbarisë, prerjes së flokëve", për herën e parë.

Kryesore e ritit është forcimi i besimit reciprok midis familjeve. Titullin "kumbar" ose "nun" e fiton një person me autoritet, ky mbetet një mik shumë i rëndësishëm. Ai mund të përfaqësojë familjen gjatë ndryshimeve në jetën e individit, pra bëhet pjesëtar i asaj familje. Prerja e flokëve të fëmijëve bëhet në moshën 1-2 vjeç. Ditën e caktuar, zoti i shtëpisë së bashku me të afërm, organizon një gosti sipas mundësisë. Pas cermonisë dhe ngrënjes ngrihej sofa, e kumbari ose nuni i priste fëmijës disa fije flokësh duke filluar nga balli, temthat dhe qafa. Prerja bëhej me gërshtë ose me brisk te cilat mbahen në një tabaka me mbulesë të bukur. Kumbari nuni jep lek ose dhurata të mira për djalin që ka qethur, po kështu japin edhe personat e tjerë që janë në këtë cermoni.

Flokët nuni ia dorëzonte nënës së fëmijës e cila i ruante në një vend të sigurtë e të fshehtë. Kumbaria është dukuri e trashëgueshme prandaj personi nuk ndërrohej. Krishtërimi e përvetësoi fenomenin e kumbarisë. Ai e shpalli kumbarin edhe ndërmjetës të brezave dhe si ndihmës të priftit në ceremoni të ndryshme familjare. Në rast pas rasti këto gosti organizohen deri me orkestra dhe me harxhime të kosiderushme me pjesëmarrje të gjerë të të afërmeve.

VII SYNËTLËKU

Pas 2-3 vitesh për djemët është zakoni i bërjes synet për besimin mysliman.

Për këtë si zakon quhesh edhe një dasëm e vogël, dhe kur e uronin me fjalët tani ne "dasmën e madhe".

Në cermoninë e kësaj gostije mund të bëheshin edhe 2 fëmijë synet në një ditë, orgnizohesh cermoni e madhe me dreke e darkë ku shkonte deri 24 orë, duke thirrur mbi 100 persona ne cermoni.

Merret orkestëra sipa zakonit e traditës, përgatiten ushqime të mira me mishra dhe bakllava, raki e këngë të vazhdueshme gjithë kohës, kur janë dy fëmijë i hipin në kuaj dhe i shëtisin për rreth një rrugë të hapur dhe pastaj bëhet adeti i sunetllëku dhe shtrohen gostitë.

Sigurohesh Xhovaku, (berberi, kirurgu). Në kohën e kryerjes së aktit të gjithë orkestra është në levizje dhe duke kënduar e kërcyer, kur janë daulle i bien me forcë të madhe për gjithë kohën e adetit që të mos dëgjohen qarjet e fëmijës.

Të gjithë pjesëtarët në cermoni hedhin peshqeshe e dhurata sipas rastit dhe mundësisë që kanë ose dhe monedha të ndryshme. Mund të sjellin dhuratë edhe

një dash të madh të vendosura dy kokrra molle në brirë, e kokën të lyer me bojë të kuqe. Prindërit apo të afërmit i blenë djalit rroba të reja, kostume apo dhurata të madha. Pas bërjes së synetit djali rrinte i veshur me fustane të gjatë të bardhë për disa ditë derisa të mbyllet plaga. Prindrit kujdesn duke i përgatitur ushqime më të mira dhe të lehta, të afërt dhe miqësia vijjnë për vizita duke sjellë dhurata .

VIII KËNGËT QË I KËNDOHEN FËMIJËS

Këngët janë të shumta dhe nga më të ndryshmet melodioze, të ëmbëla ku nëna shpreh dëshirën e mrekullueshme për fëmijën. Kënga e djepit këndohet nga nëna kur e vendos në gjumë. Ato janë plot krahasime nga bota e luleve dhe me një vijë melodioze të ëmbël, duke patur kenqasi, dashuri krenari dhe shpresa. Ninullat shprehin edhe dëshirën e familjes dhe ëndrrat e nënës për të ardhmen e vogëlushit. Aktualisht, zakonet e lindjes kanë ndryshuar në raport me të kaluarën. Një pjesë e tyre janë ruajtur dhe vazhdojnë të aplikohen në ceremonitë familjare. Si:

*Nina nano djalin o
Të më rritesh nënës o
Të rritesh si Skëndërbeu
Të të dojë mëmëdheu*

*Nina nano Çupës o
Të më rritesh dritëz o
Të më bëhesh si flori
Si për prindër dhe për miqësi etje....*

IX TRADITA KRISHTERE

E veçantë ishte pagëzimi në kishë, sipas zakoneve krishtere, me këtë rast i vendoset një emër tjetër hyjnor i quajtur emri i pagëzimit, ky duhet të kishte ngjashmëri me atë emër që i kishin vendosur prindrit. Edhe feja krishtere ritet e lindjes së fëmijës i ka pasur në ngjashmëri po dhe me ndryshimet e saj. Nuni kishte për detyrë të ngjiste emrin krishter duke e lidhur ngushte me emrat e dëgjuar krishterë si: Shën Naun, Shën Thanas e tje. Kur vendosesh emri zyrtar duhet të ishte sa më i përafërt me emrin e pagëzimit. Nuni do të zgjidhesh sipas fëmijës lindur për djem mashkull dhe për vajzat femra. Sapo merrej vesht lindja e një fëmije, prindrit lajmëronin "ninin" që i caktonin fëmijës para lindjes së vet.

Caktimi i nunit të fëmijës së vet prej prindit përbën në vetevete një granci për fëmijën në jetë. Ky mbetet një udhërrëfyes i jetës së fëmijës. Merr pjesë në çdo eveniment dhe aktivitet familjar që do të ketë fëmija.

X TË TJERA

Përveç këtyre kq edhe rite e zakone të tjera të cilat kurlivohen me ecjen e moshës, kështu kur fëmija fillon të njohë sendet që e rrethojnë lidhen me edukimin e shprheive për punën e jetën. Kështu para i vendosin disa vegla pune si lopatë, çekan, sqepar, ose mjete të tjera si lapsa, fletore apo libra dhe e dergojmë që fëmija të kapi ato që ka parpara. Po kapi vegla pune ai do të behet puntor, po kapi mjete shkollore ai do të beht i shkolluar. Këto rite bëhen nga prindër me prirje intelektuale për të zbuluar prirjen që ka fëmija i tyre dhe të angazhohen për edukimin e tyre sistematikisht deri në moshën e pjekurisë shkollore lidhur me përzgjedhjen e drejtimit që do të zgjedhë vetë .

Ritet dhe zakonet pozitive duhet të njihen nga prindrit, të aplikohen dhe të shoqërojnë në vazhdimsi rritjen e fëmijës. Në material, ka rite tradita e zakone, vërejmë se shqiptarët e krahinave të ndryshme kanë tradita të pasura të cilat duhet të ruhen, por ka edhe tradita që duhet ti njohim por ose dhe jo ti praktikojmë.



Asfaltohet rruga Urakë - Golik

Rruga problematike që lidh Mokrën me Përrenjasin është sh-truar në një segment të saj. Ndërkohë po vijon puna për segmentin tjetër Qukës - Golik dhe në pritje të segmentit, aksit të madh Qukës - Qafë-Plloçë. Vitin që vjen pritet të asfaltohen edhe disa segmente rrugësh në komunën e Proptishtit e Velçanit